



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: KASTRATI SHA / MAK ALBANIA SHPK

Autoriteti i Konkurrencës, në datë 18.01.2018 me shkresën Nr. 41 Prot, ka marrë njoftimin mbi transaksionin e realizuar me anë të “Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve” nga pala blerëse.

Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 17 .01.2018, synohet të realizohet përfitimi i kontrollit të plotë të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK nga shoqëria KASTRATI SHA, në mënyrë të drejtpërdrejte, me anë të përfitimit të 100% të kuotave të shoqërisë.

Ky njoftim bëhet për shkak se palët plotësojnë kriteret e xhirove në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi, **shoqëria Kastrati SHA**, është shoqëri aksionare e cila vepron sipas ligjeve të shtetit shqiptar, me NUIS K21711502V e themeluar në datë 30.05.2002, me objekt krijimin, instalimin dhe vënien në shfrytëzim të impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashtë vendit, import-eksport dhe tregti me shumice e naftës, gazit, etj. Për ushtrimin e aktivitetit të grumbullimit, demolimit dhe shitblerjes së skrapit, hekurishteve dhe mbeturinave të tyre etj. tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve industrialë etj.

Shitësit/:

Heritage Glory Albania, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ekziston nën Ligjet e Ishujve Cayman e themeluar më datë 08.04.2009. Kjo shoqëri zotëron 97.98% të kuotave të kapitalit të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK,

Z. Fawzi M.A. Alkhourafi, shtetas kuvajtian, me banim në Kuvajt i cili zotëron 1.01 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK,

Z. Loay MA Alkharafi, shtetar kuvajtian, me banim në Kuvajt, i cili zotëron 1.01 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë MAK ALBANIA SHPK. Kuota e tij prej 1.01% është e zotëruar bashkërisht nga të tetë trashëgimtarët e tij.

Targeti, **MAK ALBANIA SHPK**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila vepron sipas ligjeve të shtetit shqiptar, me NUIS J61821059A e themeluar në datë 18.05.1994, me objekt “Zhvillimi i veprimtarive private tregtare në fushën e ndërtimeve të ndryshme me karakter turistik, industrial social, ndërtim banesash, etj. Gjithashtu, objekt i

veprimtarisë së saj do të jetë: (i) veprimtari tregtare të import eksportit, të turizmit; veprimtari ndërtuese, administruese, menaxhuese të një hoteli turistik të një niveli të larte etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.